

#2100
Mbjellja e një vizioni
Nehemia 2:11–20

A mund të kthehemi te Nehemia, më saktë te kapitulli dy? Nëse më lejoni, do të doja të lexoja gjysmën e dytë të kapitullit 2, para se ta shohim atë më nga afër.

“Kështu arrita në Jerusalem dhe qëndrova atje tri ditë. Pastaj u ngrita natën me pak burra të tjerë, por nuk i thashë gjë asnjëriut nga ato që Perëndia im më kishte vënë në zemër të bëja për Jerusalemin. Nuk kisha me vete asnjë kafshë tjetër barre, veç asaj së cilës i kisha hipur.

Dola natën nga Porta e Luginës, në drejtim të Burimit të Dragoit dhe të Portës së Plehut, duke kontrolluar kështu muret e Jerusalemit, që ishin plot me të çara dhe portat e tij të konsumuara nga zjarri. Vazhdova pastaj për nga Porta e Burimit dhe Pishina e Mbretit, por nuk kishte vend nga të kalonte kafsha mbi të cilën kisha hipur. Atëherë iu ngjita natën luginës, duke vëzhguar gjithnjë muret; më në fund u ktheva prapa, duke hyrë nga Porta e Luginës, dhe kështu u ktheva. Zyrtarët nuk e dinin se ku kisha shkuar dhe as me se isha marrë. Deri në atë çast nuk u kisha thënë asgjë judenjve, priftërinjve, fisnikëve, zyrtarëve dhe as atyre që merreshin me punimet.

Atëherë u thashë atyre: «Ju e shikoni gjendjen e mjeruar në të cilën ndodhemi: Jerusalemi është shkatërruar dhe portat e tij janë konsumuar nga zjarri! Ejani t’i rindërtojmë muret e Jerusalemit, dhe kështu nuk do të jemi më të turpëruar!». U tregova pastaj atyre si dora bamirëse e Perëndisë tim kishte qenë mbi mua si dhe fjalët që mbreti më kishte thënë.

Atëherë ata thanë: «Të ngrihemi dhe t’i vihemi ndërtimit!». Kështu morën zemër për t’i forcuar duart e tyre për këtë punë të rëndësishme.

Por kur Sanbalati, Horoniti dhe Tobiahu, shërbëtori amonit, dhe Geshemi, arabi, e mësuan këtë gjë, filluan të tallen dhe të na përbuzin, duke thënë: «Çfarë po bëni? Mos doni, vallë, të ngrini krye kundër mbretit?».

Atëherë unë u përgjigja dhe u thashë atyre: «Do të jetë vetë Perëndia i qiellit që do të na sigurojë suksesin. Ne, shërbëtorët e tij, do të fillojmë ndërtimin, po për ju nuk do të ketë as pjesë, as të drejtë, as kujtim në Jerusalem.»

O Atë, ne sërish shohim drejt teje që je Zoti i Fjalës, teksa i afrohem i Fjalës së Zotit. Ne lutemi që me anë të Frymës sate të na mësosh, për hir të Jezusit. Amen.

E kam kapur veten paksa të papërgatitur, për shkak se nuk u kam kushtuar vëmendje udhëzimeve. Kjo ndoshta tregon se sa shumë po e prisja drekën—pak a shumë një gabim pa dashje, që të falënderoja për drekën—gjithsesi, është mirë që t'u paraprijmë paksa gjërave. Ja ku jemi, pra.

Ajo që dua të bëj, është të mendojmë për këtë gjë nën titullin “Mbjellja e një vizioni” apo “Zbritja në tokë e një vizioni”. Ky vizion u ngjiz në zemrën e Nehemias, si rezultat i ndërhyrjes së Perëndisë në jetën e tij, por siç aludua edhe në sesionin e parë, nëse duam të jemi të efektshëm në udhëheqje, duhet të jemi në gjendje që ta paraqesim këtë vizion në terma sa më praktikë dhe në mënyra të kuptueshme, si për ata që do të na ndjekin, ashtu edhe për ata që do të përfshihen në detyrat praktike, dhe kjo, sigurisht, është ajo që shohim këtu.

Dua që ta ndjekim këtë proces duke përdorur disa fjalë; mendoj se janë tetë fjalë, nëse më kujtohet mirë. Po, janë tetë fjalë. Kam pak a shumë tetë kremastarë, në të cilët do të var rrobat e materialit tonë.

Çlodhja

Fjala e parë mund t’ju befasojë paksa; ajo vjen nga vargu 11: “Kështu arrita në Jerusalem dhe qëndrova atje tri ditë...” Fjala e parë është *çlodhje*—çlodhje. Kjo fjali është e atij lloji, të cilin shumica prej nesh kanë prirjen të mos i kushtojmë vëmendje; kjo thjesht na jep informacion. Jep një shënim kronologjik për atë që po ndodh.

Jam i tunduar të sugjeroj—sigurisht që gjithmonë duhet të ruhem nga *eisigesis* ([aisixhizis] t’i veshësh tekstit kuptimin ose opinionin tënd)—por jam i tunduar të sugjeroj që këtu ka diçka të cilën mund ta shpërfillim shpejt dhe kështu të na shpëtojë diçka e rëndësishme. Duke qenë se Nehemia mezi e ka pritur këtë moment, pasi ka bërë një udhëtim kaq të gjatë prej disa qindra kilometrash, pasi ka arritur në afërsi të zonës së mundësisë, a nuk do të prisnim që ai do t’i futej punës menjëherë? Që ai do t’i mblidhte bashkë njerëzit që ishin aty, do t’u jepte disa skica për atë që duhej bërë, dhe kështu t’i futeshin punës?

E po, nëse do të kishim pritur këtë, sigurisht që nuk ishte kjo ajo që ndodhi. Ai çlodhet për tri ditë. Ndoshta një prej tyre ishte edhe dita e shabatit—nuk e dimë me siguri, por duket se, të paktën, kjo do të ishte pjesë e modelit. Duke kaluar tri ditë, duket se ai pranoi që çlodhja është pjesë e nevojshme e veprimit të dobishëm. Çlodhja nuk duhet të shpërfilllet, të anashkalohet dhe të refuzohet. Por kjo ka prirjen të ndodhë në shumë prej modeleve bashkëkohore të jetës së biznesit, ku udhëheqësit e suksesshëm në tregti dhe industri duket që janë në gjendje ta bëjnë kalimin nga një kontinent në tjetrin, nga një avion në tjetrin dhe nga zyra në mundësi shërbese, me sa më pak vështirësi dhe sa më shumë rehati. Kjo mund të ndodhë lehtë edhe në sferën e aktiviteteve të kishës. Por, si fillim, unë do t’ju sugjeroja se ky nuk është një model i mirë për t’u ndjekur. Përkundrazi, ne kemi nevojë të mësojmë se sa e rëndësishme është që të kalojmë kohë për t’u çlodhur dhe për t’u ripërtërirë. Tek Ezdra 8:15 lexojmë: “Unë i mblodha pranë lumit që

rrjedh në drejtim të Ahavës dhe fushuam aty tri ditë.” Po ashtu, tek Ezdra 8:31-32 thuhet: “Ditën e dymbëdhjetë të muajit të parë u nisëm nga lumi Ahava për të shkuar në Jerusalem; dora e Perëndisë tonë ishte mbi ne dhe gjatë udhëtimit na liroi nga armiku dhe nga pritat e tij. Arritëm kështu në Jerusalem dhe qëndruam tri ditë atje.”

Duket sikur këtu ka një lloj modeli, një mënyrë funksionimi, e cila ishte thelbësore për shpalosjen e veprimeve që do të ndërmernte. Kjo ka shumë kuptim. Udhëtimi nga Babilonia në Jerusalem ishte shumë i gjatë. Kaloje mospërmas shkrete për pothuajse nëntëqind kilometra. Nëse do të ndiqte rrugën e Gjysmëhënës Pjellore (Fertile Crescent), dhe ka të ngjarë që andej kaloi, atëherë, udhëtimi ishte 1 300-1 500 kilometra. Pas një udhëtimi kaq të gjatë dhe të lodhshëm, detyra të cilës do t'i kushtohet, ishte jashtëzakonisht e rëndësishme, prandaj ishte e domosdoshme që ai të ndalonte, të çlodhej dhe të rifitonte fuqinë para se të vazhdonte.

Tani më lejoni të bëj dy komente shumë praktike. Së pari, shumica prej nesh që janë në shërbesë pastorale, duhet të kenë kujdes që të mos shprehen për faktin se sa të lodhur janë. Teksa kam udhëtuar nga një vend në tjetrin, kam vënë re që jam takuar me disa tipa të caktuar, madje, ata i shoh në pasqyrë—e kam fjalën për veten—por shpesh mund të tingëllojmë sikur po punojmë jashtëzakonisht fort. Me sa kam parë, nuk di që shumë prej nesh të jenë duke punuar më fort, në krahasim me shumë prej udhëheqësve të pashuguruar në kishë, të cilët po rropaten në kulm, duke përmbushur përgjegjësitë e rutinës së tyre të përditshme, duke u përpjekur të ushtrojnë rolin e babait dhe të bashkëshortit, duke qenë besnikë në përgjegjësitë e shërbesës brenda kishës, si dhe duke mbikëqyrur atë që po ndodh. Them se kjo është një fjalë këshille së cilës duhet t'i kushtojmë vëmendje dhe të heqim dorë nga të folurit për stërmundimin tonë. Këtë gjë e shihni edhe nëpër letrat e lutjes: “Oh, lutuni për pastor filanin; ai është jashtëzakonisht i lodhur!”.

Disa prej jush mund të kenë marrë një letër—nuk e di se kujt iu dërgua—nga programi ynë në radio, por unë isha në një udhëtim në San Francisco, për të bërë dy episode të programit tonë radiofonik “Mbrëmje me *Truth for Life*”. Mora me vete një nga kolegët e mi. Ai shkroi një raport, i cili mendoj se do t’u jetë dërguar anëtarëve të bordit tonë. Atë raport ai e dërgoi para se unë të kisha mundësi ta lexoja, dhe në një paragraf, ai shpjegonte se sa *rropatës* që ishte ky udhëtim. Prandaj e mora mënjandë dhe i thashë: “Hej, dëgjo! Ti as që e kupton fjalën *rropatës*, madje as unë nuk e kuptoj. Në fund të fundit, ç’bëmë ne? I hipëm avionit, shkuam në San Francisco, dolëm për drekë, regjistruam një emision ‘Mbrëmje me *Truth for Life*’, luajtëm golf, regjistruam një emision tjetër, pastaj i hipëm avionit dhe u kthyem në shtëpi. Këtë e quan rropatëse? Do të na pushosh të gjithëve nga puna nëse vazhdon të përdorësh mbiemra si ky!”.

Në ekipin tim pastoral kisha një burrë të cilin e pyesja: “Si je këtë mëngjes?”. Ai e kishte zakon të thoshte: “Jam i lodhur, i lodhur.” E keni parasysh, ai ishte nga “Teksasi” apo diçka e tillë. “Dëgjoni ju të gjithë; jam i lodhur.” Ju betohem që, nëse do më kishte thënë edhe një herë që ishte i lodhur, nuk mund t’ju tregoj dot se çfarë do t’i kisha bërë. Me kalimin e kohës, ai u largua vetë. Ndoshta sot është shtrirë diku, në ndonjë stol në park, dhe po merr një sy gjumë, sepse është “i lodhur”. Ai nuk ka qenë kurrë i lodhur në jetën e tij; ai është lodhur, ngaqë nuk bën asgjë! Të pakta janë ato profesione në jetë që të japin një mundësi të pabesueshme për të mos bërë asgjë, të cilat janë të barabarta me shërbesën pastorale.

Për këtë mund të flasim në një sesion me pyetje dhe përgjigje, por për momentin do të jetë monolog. Le të tregohemi të sinqertë, shumica prej nesh nuk rrezikojnë të arrijnë në pikën e drobitjes. Trashja është mundësi reale; kërrusja nën peshën e kekëve; ndërtimi i këtyre mbajtëseve të vogla të filxhanëve të kafesë, për të cilat fëmijët mendojnë se janë kusht për t’u

përfshirë në shërbesë pastorale—më së shumti në Skoci, ku mund t’i dallosh profesionistët e vërtetë, sepse në konferencat e pastorëve, ata nuk i mbajnë në dorë filxhanët e kafesë, pasi kanë ndërtuar një mbajtëse mbi të cilën filxhani qëndron për bukuri—aty rri vetë. Më besoni kur ju them se problemi i tyre nuk është aktiviteti i tepërt.

Këtë e them për shkak se ajo që do të them tani, është krejt e kundërta e kësaj. Por nuk dua që ndokush të mendojë, sidomos nëse këtu kemi disa pleq kishe, të cilët kanë një punë si profesion jashtë kishës, nuk dua që ndokush të mendojë se ne themi: “Oh! Ua! E di çfarë? Ne vërtet po e bëjmë punën!”.

Tani që e kam thënë këtë, është e mundur që të lodhesh. Ka gjëra të cilat kërkojnë shumë energji nga ne, dhe këtë e dimë nga përjetimi se zakonisht ne jemi të fundit që e dallojmë se sa të lodhur jemi. Ajo që ndodh është që rendimenti ynë bie. Aftësia jonë për t’u përballur me rutinën e përditshme bie. Kemi prirjen që të shpërthejmë ndaj njerëzve dhe të reagojmë ndaj tyre në mënyra të cilat nuk tregojnë fare hir të krishterë. Prandaj, kemi nevojë t’i hedhim një vështrim serioz mënyrës se si po përpiqemi që ta përfshijmë çlodhjen në skemën tonë të themelimit të vizionit.

Më lejoni të them kalimthi, unë besoj se është e detyrueshme të merrni një ditë pushim. Dita ime e pushimit është e marta. Për aq kohë sa jam në qytet i qëndroj besnik kësaj në mënyrë absolute, me përjashtim të vdekjes—vdekjes sime ose të dikujt në bashkësi, apo nëse ka ndonjë problem të madh pastoral. Me përjashtim të këtyre rasteve, të martën e bëj pushim. Kam miq të cilët besojnë se janë pastorë shumë më të mirë se unë, dhe kjo sigurisht që është e mundur, por arsyeja nga e cila vendosin kështu është për shkak të faktit që nuk kanë pushim. Ata janë shumë të mbingarkuar, thjesht kanë shumë gjëra për të bërë, kanë shumë përgjegjësi.

E po, nuk kam qenë gjithmonë në një pozitë luksi, siç jam tani në Amerikë. Kur isha në Skoci punova për tetë vjet—dy prej tyre si asistent në Edinburg, kur vizitoja dyzet-pesëdhjetë njerëz në javë, si pjesë e përgjegjësisë sime si asistent, duke zbritur dhe duke iu ngjitur shkallëve të apartamenteve. Pastaj, kur shërbeja vetë në një kishë në perëndim të Skocisë, kisha një telefon, por ai gjendej në korridorin e ndërtesës dhe ishte me pagesë. Unë pastroja sallën, hiqja të gjitha qeset e patatinave, hapja karriget, vendosja tavolinat, gjeja mbulesa të kadifenjta, i shtroja mbi tavolina, gjeja një kavanoz reçeli, vendosja lule në të, për t'u bërë gati për takimin e mesjavës. Pra, edhe këto lloj punësh i kam bërë. Në fakt, kam edhe një bluzë. Niveli i presionit që përjetojnë disa prej nesh, dhe çlodhja për të cilën kemi nevojë, janë të lidhura me mendjen tonë. Nën dritën e faktit se nga vinte ai burrë dhe se ku po shkonte, mund ta imagjinoj që ai u përpoq ta bënte këtë.

Kur e shohim që jemi të stërmunduar, ka disa gjëra të cilat nuk duhet t'i bëjmë. E para, nuk duhet të marrim vendime të rëndësishme. E dyta, nuk duhet të shkruajmë letra të rëndësishme. E treta, nuk duhet të nisim projekte të reja. E katërta, nuk duhet t'i ndërpresim projektet e vjetra. E pesta, nuk duhet të heqim dorë. E gjashta, nuk duhet të bëjmë vlerësimin e gjendjes frymërore të dikujt tjetër. Dhe e shtata, nuk duhet të bëjmë vlerësimin e gjendjes sonë frymërore. Nuk duhet ta bëjmë, sepse, në më të shumtën e kohës, do të jemi të ndikuar në mënyrën se si e perceptojmë atë që po ndodh. Sërish, kërkohet dikush i cili na njeh mirë, që të na vërë në dukje situatën kritike në të cilën gjendemi, sepse sa më të lodhur që të jeni, aq më tepër keni prirjen që ta rritni nivelin e aktivitetit tuaj të furishëm, sepse mund ta dalloni edhe vetë, në ekipet e futbollit, të duhet më shumë kohë për të kapur topin kur ju bëhet një pasim, prandaj, kjo ju tiranizon dhe ju përpiqeni gjithnjë e më fort, kur, në fakt, ajo që duhet të ndodhë, është që duhet të zëvendësoheni. Sepse tani e keni humbur aftësinë, e keni humbur hovin për ta arritur

topin—por për ta bërë këtë kërkohet urtësi. Duket qartë që Nehemia ishte i urtë dhe ai nuk kuptoi rëndësinë e përtacisë, por atë të çlodhjes. Ka të ngjarë që thashë më shumë se duhet për këtë pikë.

Motivimi

Gjithsesi, fjala e dytë është *motivimi*—motivimi—në vargun 12: “Pastaj u ngrita natën... por nuk i thashë gjë asnjëriut nga ato që Perëndia im më kishte vënë në zemër të bëja.” Fjalët “në zemër” janë çelësi—“në zemër”. Çfarë kishte “në zemër”—në qendër të qenies së tij? Çfarë të motivon, Nehemia? Pse je përfshirë në këtë gjë? Pse erdhe vallë? Çfarë planifikon të bësh?

Ai nuk kishte folur ende për asnjërën nga këto me njerëzit që do të përfshiheshin. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme, sidomos kur brenda nesh kemi një dëshirë dhe një pasion për t’i parë gjërat që të ndodhin—kur kemi njëfarë përgjegjësie që t’ua komunikojmë atë vizion të tjerëve, të cilët, në fakt, do ta vënë vizionin në zbatim. Kjo për shkak se në dimensionet fillestare të vizionit është e mundur që njerëzit të reagojnë në lloj-lloj mënyrash, të na shohin ne dhe të dalin në përfundime të çfarëdoshme. Për shembull, nga jashtë, vëzhguesit mund ta kishin parë Nehemian që erdhi në Jerusalem, dhe të thoshin: “Oh, ja, pra. Ja ku po vjen ai që po ndërton perandorinë. Ai ka ardhur këtu që të fitojë famë për emrin e tij. Në fund të fundit, pse të udhëtojë dikush për një mijë e pesëqind kilometra? A mendon ai se është vërtetë kaq i rëndësishëm? A mendojmë se kemi vërtetë nevojë për të?”.

E po, në fakt, pas Perëndisë, ata *kishin* nevojë për të, dhe ai *nuk* mendonte se ishte dhe aq i rëndësishëm. Për shkak se ai nuk mendonte se ishte dhe aq i rëndësishëm, do të bëhej me të vërtetë tepër i dobishëm. Ja ku kemi sërish një paradoks të mrekullueshëm që ne, të cilët mendojmë se jemi shumë të rëndësishëm, t’i jetojmë jetët tona në përulësi. Në fakt, vetëdija për

parëndësinë tonë mund të jetë shtegu drejt rëndësisë—çka do të thotë se, në jetën dhe shërbesën e krishterë, shtegu drejt lartësisimit shkon për poshtë.

Mendoj se ka të ngjarë që ai do të kishte qenë i vetëdijshëm për ato gjëra, sikurse janë të gjithë ata që janë në udhëheqje. Posta ime, kur u ktheva dje... Ah, po! U ktheva të martën në mbrëmje dhe dje shkova në zyrën time, ku pashë se kisha një tufë letrash. Teksa po i lexoja, një pjesë e konsiderueshme ishin mesazhe elektronike, të cilat i kishin printuar për mua, sepse unë nuk jam fare i aftë me kompjuterat. Po i kaloja njëra pas tjetrës dhe po lexoja një mesazh që më kishte dërguar dikush nga Seattle, pastaj nga shtete të ndryshme; ishin vërtet inkurajuese. Në mes të këtyre korrespondencave arrita të një letër me një fjali, e shkruar nga një burrë i cili ishte larguar nga kisha, sepse nuk i pëlqenin disa gjëra në të. E dini çfarë? Nëse mospëlqimi i disa gjërave në kishë do të ishte një arsye mjaft e mirë për t'u larguar, unë vetë do të isha larguar nga kisha para shumë kohësh.

Gjithsesi, ai burrë më dërgoi një letër ku shkruante: “I dashur Alistair: krenaria vjen para rrëzimit. Me dashuri, Joeli.” Prandaj, unë thashë: “E po, ky qenka mesazh shumë enigmatik! Si të reagoj ndaj këtij mesazhi? A ta mbroj veten time? A t’i shkruaj dhe t’i them: ‘Zotëri, gjithçka të bie erë të keqe, sepse të ka mbetur djathi në mustaqe’? Çfarë të bëj?”. Pastaj thashë: “Do ta marr sikur ma ka dërguar Perëndia.”

Ja ku isha unë me një gjashtëdhjetë e pesë apo shtatëdhjetë letra, të cilat të bëjnë të të rritet mendja së tepërmi, dhe në provaninë e Perëndisë, vjen një letër si kjo, që të thotë: “Hej, meqë ra fjala, po të pëlqejnë letrat, mendjemadh? Provo ta lexosh këtë!”. Perëndia ka një mënyrë të mrekullueshme se si punon. E dini çfarë? Ai flet përmes gomarit të Balaamit¹ dhe madje mund të flasë edhe përmes njerëzve që janë shkëputur nga kisha.

¹ Shih Numrat 22:21-35.

E shihni? Nehemia ishte i motivuar nga brendësia. Kurdoherë që një burrë apo një grua karakterizohen nga pasioni, ata nuk janë thjesht anëtarë të shoqatës “Ide të ndritura”, kur motivohen nga diçka që Perëndia ua ka vendosur në zemër për ta bërë, ajo gjë do të bëhet e dukshme për të tjerët. Kur mendoni për Palin që shpjegon shërbesën e tij te 2 e Korintasve 5, ai thotë: “Dashuria e Krishtit na shtrëngon.”² “Ajo na shtrëngon, ajo më motivon nga brendësia”, thotë ai. “Është dëshira ime e madhe”—1 e Korintasve 9—“që të fitoj sa më shumë njerëz.”³ Në fakt, kështu thuhet në versionin NIV. Çfarë po bën, Pal? “Po përpiqem të fitoj sa më shumë njerëz që të jetë e mundur.” Çfarë po bën Nehemia? “Kam ardhur këtu që të nderoj Perëndinë dhe lavdinë e tij. Besoj se Perëndia më ka dërguar këtu.”

Çfarë digjet në zemrën tënde? Çfarë ka brenda nesh, nëse fëmijët tanë do të na përshkruanin ne? Nëse shkoni merrni djalin tim adoleshent dhe i thoni: “Për çfarë jeton babi yt? Ma thuaj me një fjali”, çfarë do të thoshte ai? Kjo është prova reale. Jo “Çfarë thuhet në rezymenë tënde?”. Jo “Çfarë thuhet në kapakun e pasmë?”. Shpresojmë që ato të mos jenë të pasakta, por ato nuk janë aq të rëndësishme sa të pyesësh: “Çfarë po ndodh brenda teje? Çfarë të motivon? Çfarë të shtyn? Çfarë të nxit?”.

Një nga shokët e mi më të afërt, i cili vdiq para disa vjetësh, ishte një irlandez i vogël i quajtur T. S. Mooney. Ai udhëhiqte një nga klasat e studimit biblik për djem ose vajza, dhe po ashtu, kishte një grup djemsh—në Londonderry të Irlandës së Veriut për pesëdhjetë vjet—pesëdhjetë vjet. Kur e pyetën se cili ishte motivi i tij për të dhënë mësim të diel pas të diele për pesëdhjetë vjet, me përjashtim të kohëve kur shkolla kishte pushime, ai tha: “Qëllimi im është që çdo djalë të ketë një Bibël në dorë, një Shpëtimtar në zemrën e tij dhe një qëllim në jetën e tij.”

² 2 e Korintasve 5:14.

³ 1 e Korintasve 9:19.

Ky është lloji i qartësisë, i cili është i domosdoshëm për të bërë shërbesë. Njerëzit mund t'i bashkohen këtij lloj motivimi. Nuk ka shumë llafollogji; e keni parasysh besoj, pak a shumë fjalë të stërholluara teologjike. Ato janë thjesht fjalë! “Çfarë po bën, Nehemia? Cila është gjëja kryesore? Çfarë ke në zemër?” E po, ai nuk u kishte treguar ende.

Meqë ra fjala, shoku im, për të cilin ju fola më sipër, kur e pyeta se përse nuk ishte martuar kurrë—në atë kohë, ai ishte shtatëdhjetë e nëntë vjeç—ai më tha: “E po, arsyeja pse nuk u martova kurrë është shumë e thjeshtë: sepse më mirë ta kaloj jetën duke dashur atë që nuk e kam, sesa të kem atë që nuk e dua.” Ai ishte mjeshër për t'i thënë gjërat në mënyrë koncize. Disa prej nesh kanë nevojë ta mësojnë këtë art; këtu përfshij edhe veten. Le të kalojmë te pika e tretë.

Vëzhgimi

Çlodhje, motivim, *vëzhgim*—vargu 13. Nëse duam që të mbjellim një vizion, atëherë kemi nevojë të çlodhemi, që kur të çohemi në këmbë, të kemi mundësi të ecim përpara. Nëse duam që të mbjellim një vizion, kemi nevojë të motivohemi nga një shqetësim, i cili na është dhënë nga Perëndia dhe nuk është krijuar nga njeriu. Sepse, siç tha edhe Robert Burns-i, “Planet më të mira të minjve dhe të njerëzve shpesh dalin huq.”⁴ “Dola natën nga Porta e Luginës, në drejtim të Burimit të Dragoit dhe të Portës së Plehut, duke kontrolluar kështu muret e Jerusalemit, që ishin plot me të çara dhe portat e tij të konsumuara nga zjarri.” Ai na përshkruan këtë mision të vogël zbulimi. Në mendjen e tij, ai e kishte të qartë se çfarë duhej bërë, në zemrën e tij ishte i sigurt në lidhje me motivimin e tij, dhe tani, ai sheh me sytë e vet se si mund të realizohet.

⁴ Robert Burns, “To a Mouse, on Turning Her Up in Her Nest with the Plough” (1785).

Mendoj se kjo është pika ku disa prej nesh rrëzohen: në gatishmërinë tonë për ta zbatuar vizionin, ne na shpëton pjesa e zbulimit. Prandaj kur ata që janë inxhinierë në mesin tonë, të cilët mendojnë në progresione lineare dhe janë shumë të zgjuar, përballen me këtë lloj fjalimi artistik, pseudofilozofik dhe teologjik, ata janë gati t'i bien shkurt dhe të thonë: “Alistair, nuk jam shumë i sigurt që ti e kupton atë që po thua.” Kjo është shumë e dhimbshme, por ama edhe shumë e dobishme. Arsyeja pse shpesh nuk e kuptojmë, nuk është sepse nuk jemi të motivuar, nuk është sepse nuk jemi çlodhur dhe nuk jemi gati për të vazhduar; arsyeja është sepse nuk e kemi bërë *këtë* pjesë. Nuk kemi kaluar kohë për të bërë vëzhgimin. Nuk kemi menduar për këtë gjë.

Vini re tiparet dalluese të këtij vëzhgimi. Së pari, ai e bëri këtë gjë me qetësi—me qetësi. Mendoj se ky është kuptimi i frazës së fundit në vargun 12: “Nuk kisha me vete asnjë kafshë tjetër barre, veç asaj së cilës i kisha hipur.” Nuk mendoj se ai po tregon faktin që ai kishte një gomar dhe të tjerët nuk kishin. Ky nuk është shpirti i udhëheqjes—kjo nuk është udhëheqje shërbëtore. Nehemia nuk është i tillë. Mendoj se kjo është një shprehje e faktit që gjëja e fundit që do të doje në një mision të tillë, do të ishte që të dëgjoheshin shumë gërritje dhe hingëllima kuajsh—nuk do të doje shumë zhurma të tilla. Dua të them që kuajt bëjnë lloj-lloj zhurmash. Nëse ke qenë në ndonjë paradë ushtarake, e di që nuk do të doje të ishe në radhën e parë.

Prandaj, ai nuk do të ketë gjëra të tilla. Ka një kohë për të qenë në heshtje dhe një kohë për të folur.⁵ Ai nuk erdhi me shumë zhurmë, si ndonjë tip autoritar; nuk kishte lajmërimë që thoshin: “Javën që vjen, mbërrin Nehemia.” “Nehemia po vjen në qytet”, diçka të tillë. Nuk kishte budallallëqe të tilla. Nuk kishte asgjë të tillë si salltanetet e ungjillorizmit klasik amerikan. (Ju kërkoni ndjesë!) Nëse kisha juaj është *kaq* e madhe, atëherë ajo reklamohet me një foto të *kësaj* madhësie. Nëse kisha është më e madhe se *kaq*, atëherë ju ofrohet një foto më *e madhe*.

⁵ Shih Predikuesi 3:7.

Nëse kisha juaj është *shumë* e madhe, atëherë ju ofrohet i gjithë kapaku i pasëm. Nëse kisha juaj është e vogël, as që duan t’ia dinë se kush jeni. Zoti pastë mëshirë për ne, për gjithë këto *gjëra!* Nehemia vjen me qetësi në qytet—me qetësi. Disa prej nesh e kanë të vështirë të jenë të qetë.

Në fakt, ai vjen në fshehtësi—në fshehtësi! Kjo thekson faktin pse ai vjen natën. Në vargjet 12, 13, 15 dhe në vargun 16, ai thotë: “Zyrtarët nuk e dinin se ku kisha shkuar dhe as me se isha marrë.” E po, si përputhet kjo me të qenët plotësisht transparent? Mirë, pra, ka një kohë për të qenë plotësisht transparent, por ka një *kohë* për transparencë të plotë. Nëse e bën transparencën të plotë tepër herët, njerëzit mund të mos jenë në gjendje ta përballojnë, dhe për më tepër, sikurse ju sugjerova, mund të zbulojmë gjëra të cilat ende nuk i kemi menduar mirë. Kështu, në vend që të themelojmë një vizion, ne thjesht themelojmë rrëmujë. Dhe na duhet shumë kohë që t’i riparojmë dëmet; do të na duhet t’ia nisim nga e para.

Sot në mëngjes, një zotëri më mori me makinë nga aeroporti dhe më solli këtu. Gjatë rrugës, ai po më pyeste për tranzicionin nga Skocia në Amerikë—dhe unë i thashë se pasi kisha qenë në kishë për afërsisht tre vjet, papritur e kuptova që do të më duhej t’ia filloja sërish nga e para. Nuk u thashë të gjithëve që po filloja sërish nga e para, dhe vetëm ata që kishin një perceptim të fortë, e kuptuan. Mirëpo, në thelb, m’u desh t’ia nisja nga e para, duke qenë se tre vitet e para kisha lloj-lloj supozimesh. Tre vitet e para përcojta një material shumë të mrekullueshëm dhe askush nuk e kishte idenë se çfarë po bëja, pastaj kuptova që Mark Twain-i kishte të drejtë: “Ne jemi dy kombe të ndara nga një gjuhë e përbashkët.”⁶ Kuptova se litarët që po tërhiqja, nuk po i tundnin kambanat, sepse, në realitet, litarët nuk ishin të lidhur me ndonjë kambanë. Dhe njerëzit që në njëfarë kuptimi ishin kambanat, nuk po lëshonin ndonjë tingull. Ata s’mund ta kuptonin dot se pse vallë po e tërhiqja me kaq zell atë copë litari. Prandaj na u desh të

⁶ Fakti që kjo thënie i atribuohet Twain-it debatohet dhe ka të ngjarë të jetë i gabuar.

ktheheshim dhe t'ia nisnim nga e para. Cili ishte problemi? Nuk kisha bërë pjesën e vëzhgimit! Nuk e kisha bërë misionin e zbulimit. Kisha hamendësuar shumë gjëra, shumë shpejt, dhe isha hedhur menjëherë në veprim.

Mendoj që ai i bëri gjërat në fshehtësi më së pari, që të sigurohej që kur më në fund ta bënte të ditur planin e tij, ta dinte që ishte i arritshëm, dhe gjithashtu për t'i parandaluar armiqtë e tij, të cilët mund ta pengonin strategjinë e tij përmes tradhtarëve.

Prandaj, për sa i përket vëzhgimit, ai ndodhi me qetësi, ai ndodhi në fshehtësi, dhe ai ndodhi në mënyrë metodike—në mënyrë metodike. Pa këtë dimension, heshtja dhe fshehtësia do të kishin fare pak rezultat. Na thuhet që ai shkoi përreth; ai arriti te Pishina e Mbretit, të cilën e dimë që në Dhiatën e Re është Pellgu i Siloamit—e mbani mend, ky ishte vendi ku Jezusi i tha burrit të verbër të shkonte dhe të lahej.⁷ është gjithmonë ngazëlluese kur lexon në Dhiatën e Vjetër dhe kupton se si ajo përputhet me të Renë. Vendi ku Ezekia kishte hapur një tunel nga brenda murit e deri te pellgu, i cili ishte jashtë, dhe kështu të siguronte furnizimin me ujë në rast rrethimi.⁸ Nëse keni shkuar në Jerusalem këto kohët e fundit, do të keni kaluar nëpër tunelin e Ezekias, madje do të jeni kërrusur mirë, ndërsa e keni eksploruar. Pishina e Mbretit është pikërisht atje.

Ndërsa Nehemia e bën këtë mision zbulimi në mënyrë metodike, ai kupton që gurët e murit janë rrokullisur tatëpjetë taracave të thepisura. Për shkak se janë rrokullisur tatëpjetë, ai nuk ka mundësi ta vazhdojë misionin hipur mbi kafshën e barrës, prandaj zbret dhe e tërheq gomarin. Ju mund ta imagjinoni Nehemian duke shkuar rreth Jerusalemit dhe duke krijuar një tablo të asaj që duhej të ndodhte. Ndoshta po mbante shënime se kush duhej të përfshihej, dhe po

⁷ Shih Gjoni 9:7.

⁸ Shih 2 i Mbretërve 20:20; 2 i Kronikave 32.

i lutej Perëndisë që ta bënte të qartë konceptin në mendjen e tij, para se ai t’ua paraqiste atë punëtorëve.

Kjo, pra, është sfida e asaj që bëjmë në udhëheqje, apo jo? Kjo është përgjegjësia jonë, që t’i ndërtojmë shenjtorët, në mënyrë që ata të mund të bëjnë veprat e shërbesës,⁹ dhe nëse do ta bëni punën e Perëndisë në mënyrën e Perëndisë, atëherë nuk do të thotë që “shërbesëtarët” jemi ne. (Nuk jam duke lënduar njeri në këtë pikë. Këtu nuk po flasim për emërtimet.)

Mirëpo, zotëria me të cilin kalova kohë fundjavën e kaluar në Irlandë, po më shpjegonte se sa i mbingarkuar që ishte, se sa shumë energji që kërkonte puna e tij, se sa të larta ishin pritshmëritë dhe gjithë gjërat e tjera. Me shumë hir u përpoqa t’i thosha: “E di çfarë? Duhet të fillosh ta bësh këtë gjë në mënyrë biblike. Duhet të jesh gati që të jetosh me rezultatin e zbatimit të një strategjie biblike dhe ta bësh këtë në mënyrë metodike.”

Me fjalë të tjera, nëse e merr broshurën e kishës sate dhe shikon se çfarë thotë poshtë emrit tënd, atje e dallon që ka një mangësi. (Kjo mund të jetë e vërtetë edhe për këtë kishë, dhe në atë rast Dr. Xhei do të më flasë ashpër. Por nuk ka problem, mund ta bëj një diskutim edhe me të.) Por atje thuhet: “Mirë se vini në kishë!”, dhe pastaj jep një listë të njerëzve kyç. Dakord, pra, cili është emri i parë? Apo jo? Pse na vendosin të parët? Sepse duam që të gjithë ta dinë se ne jemi personi më i rëndësishëm aty, apo jo? Nuk e di. Gjithsesi, aty e keni.

Ne, pra, e kemi emrin; në rregull, ndoshta është vendosur sipas rendit alfabetik. Por më poshtë thotë: “*shërbesëtari*”—“*shërbesëtari*.” Nuk është e nevojshme të jesh shkencëtar që ta kuptosh se çfarë po themi: “Ne e japim ofertën që *shërbesëtari* të mund të bëjë atë që *shërbesëtari* duhet të bëjë si *shërbesëtar*—domethënë, të shërbejë. Lëreni atë t’i futet punës. Nuk ka arsye që ne t’i ndërhyjmë.” Prandaj, kur *shërbesëtari* fillon të zbulojë një model të Dhiatës së

⁹ Efesianëve 4:12 (parafrazim).

Re për kryerjen e shërbesës dhe zbulon që ai nuk është *shërbesëtari*, por që ai është bari-mësues, që ai është një bari, që ai është një mësues, që ai është një udhëzues, që ai është një shërbëtor, dhe si rezultat i shpalosjes së Shkrimeve, njerëzit vetë bëhen shërbesëtarë, atëherë, kjo e hedh kishën në shërbesë.

Por sfida është kjo: Si ta bësh këtë? Si mund të bësh një mision zbulimi gjatë natës, për të gjetur se ku do të përfshihen Xho, Maria, Fredi, Billi dhe Anjeza, dhe pastaj t'u thuash atyre: “Ka një punë për Jezusin, të cilën nuk mund ta bëjë dot askush tjetër përveç jush”?¹⁰ Kjo është pikërisht ajo që po bënte Nehemia: ai po krijonte një tablo se ku do të përfshihej gjithsecili.

Nxitja

Tani, në vargun shtatëmbëdhjetë, ai kalon te *nxitja*. Çlodhje, motivim, vëzhgim dhe nxitje. Vargu 17: “Atëherë u thashë atyre: ‘Ju e shikoni gjendjen e mjeruar në të cilën ndodhemi.’” Nëse ndaloni aty për një çast, mendoj se ai po tregohet shumë bujar. Nuk është se po pres me padurim për të folur me të për strategjinë e tij në lidhje me këtë. Nuk e di se çfarë mendoni ju, por kjo më intrigon. A po u beson ai atyre? Mos vallë ka ironi në këtë që thotë? “Ju e shikoni gjendjen e mjeruar në të cilën ndodhemi?” Gjasat janë që ata *nuk* e dalluan mjerimin në të cilin gjendeshin. Është e njëjta gjë kur ju shkoni në dhomën e adoleshentit tuaj dhe i thoni: “E sheh se sa rrëmujë që është këtu?” Ai ta kthen: “Rrëmujë?! Kjo është për bukuri. Ky dekor është frymëzuar nga koha pas Luftës së Dytë Botërore. Ka ndonjë problem?”. Ju i thoni: “Kjo është rrëmujë totale!”.

Realiteti është që, nëse jetoni në mes të rrëmujës, ju nuk e dalloni rrëmujën. Këta njerëz kanë jetuar për një kohë të gjatë në këtë gjendje. Ata ishin mësuar me situatën. Oh, muri ishte

¹⁰ Elsie Duncan Yale, “There’s a work for Jesus” (1912).

rrëzuar përballë shtëpisë së tyre, ama atyre u pëlqente forma që kishte marrë; u pëlqente edhe bari që ishte rritur vende-vende! Kishte ferrishte që ishin rritur, dhe edhe pse ato ishin ferrishte, ishin disi tërheqëse. Mëngjeseve ata zgjoheshin, hidhnin vështrimin jashtë dhe dukej këndshëm në njëfarë mënyre.

Tani, Nehemia vjen dhe u thotë: “A e shihni gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodheni?”. Realiteti ishte që shumë prej tyre nuk e dallonin mjerimin në të cilin gjendeshin. Mes atyre që e dallonin atë mjerim, ishte edhe një grup tjetër i cili as që e vriste mendjen që ishte në atë gjendje. Ata ishin mësuar me këtë gjë. Pak a shumë si ajo kënga për fëmijë *Zonja ime e bukur (My Fair Lady)* ku thuhet: “Jam mësuar me fytyrën tënde.”¹¹ Dakord? Këtë po bënin këta njerëz: “Jam mësuar me mjerimin.”

“E dallon telashin?”

“Jo, nuk e dalloj.” Ata ishin mësuar me turpin.

Nuk duam që ta zbutim sfidën me të cilën po përballëj Nehemia. Do të duhej diçka shumë domethënëse për ta mposhtur apatinë e tyre. Kur vijmë te njerëz që janë lodhur, që janë shkurajuar dhe që janë të pakënaqur në punë, atëherë do t’i dëgjojmë ata të thonë lloj-lloj gjërash—sidomos kur vijmë, ndoshta në një komunitet të ri, me një ndryshim të ri; vijmë me vizion të ri, kemi qenë në një konferencë, diçka na e ka trazuar zemrën, dhe kthehemi e jemi gati t’i futemi punës. Ne do të ballafaqohemi me njerëz, disa prej të cilëve nuk ka dyshim që do të mendojnë si ata njerëz që kundërshtuan Nehemian: “E di çfarë? Këtë nuk e bëjmë dot. Nuk e di ku i ke gjetur këto ide të mëdha; duhet t’i kesh zbuluar me patjetër në kryeqytetin e Perandorisë Medo-Persiane. Tani je kthyer në Jerusalem dhe po përpiqesh të na mbushësh mendjen me këto mendime medo-persiane. Në fund të fundit, ata janë paganë!”

¹¹ Alan Jay Lerner, “I’ve Grown Accustomed to Her Face” (1956). Fjalët janë ndryshuar pak.

Kur vija për vizitë nga Skocia në Amerikë, dhe pastaj kthehesha tek udhëheqja ime, u thosha atyre: “E dini çfarë? Si mendoni për këtë?”. Kjo merrte gjithmonë të njëjtën përgjigje. Nuk dështonte *kurrë*. “Kjo më tingëllon si një ide amerikane!”, thoshte dikush. “Ku e gjete këtë ide? Në Amerikë?” Unë ua ktheja: “E po, ashtu është.” “E di, nuk e duam këtë ide këtu; këtu jemi në Skoci dhe jo në Amerikë!”

E dini çfarë? Një nga gjërat më të vështira me të cilën duhet të merrem, është të rrethohem nga një grup udhëheqësish, të cilët nuk duan të udhëheqin—të cilët nuk kalojnë kohë për t’u çlodhur, nuk kalojnë kohë për të zbuluar parimet motivuese të Fjalës së Perëndisë, nuk kalojnë kohë për të vëzhguar, dhe janë të papërgatitur për të reaguar ndaj nxitjes. Kjo është një nga vështirësitë e përhershme në një kishë. Sërish, në situatën nga e cila sapo dola unë, ky burrë ka shtatëdhjetë pleq. Shtatëdhjetë pleq! Gjashtëdhjetë prej tyre mezi lëvizin, kurse dhjetë të tjerët kanë nevojë për inkurajim. Çfarë mund të bësh? E po, disa prej gjërave që mendoj të bëj, nuk janë biblike. Prandaj duhet të kalojmë shumë kohë në lutje, që Perëndia ta krijojë atë frymë, sepse ka shumë njerëz...

Pastaj të tjerët thoshin: “E di çfarë? Këtë e kemi provuar më parë.” *Ishte* provuar më parë; këtë shohim tek Ezdra në kapitullin 4. Disa të tjerë thonë: “Hej, më fal, më fal! Këtë e bëmë një herë më parë, dështoi keq.” A jeni përballur ndonjëherë me një tip të tillë? Mendoja se këta tipa jetonin të gjithë në Skoci! Kur kalon nga një kishë te tjetra, njerëzit duket sikur rimishërohen. E keni vënë re këtë? Ai tipi të cilin menduat se e hoqët qafe përgjithmonë, ai tipi kuqalash dhe tullac, që fliste me dialektin e Glasgow-t, krejt papritur ju shfaqet si një burrë dymetrosh që tani flet me dialektin e New England-it! Po i njëjti tip! (Ju e dini që ajo puna e rimishërimit është marrëzi. Po bëja shaka! Gjithsesi realiteti nuk është edhe aq për të qeshur).

Keni gjithashtu njerëzit që thonë: “Askush nuk është i ngazëlluar për këtë.” “Kjo nuk është punë për ne; e provuam më herët, nuk funksionoi; askush nuk është i ngazëlluar për këtë.” A ju vijnë ndonjëherë letra të tilla? “I dashur pastor, dua të të shkruaj për të të thënë se jam shumë i shqetësuar për A, B, C, D”, e kështu me radhë, deri në fund të alfabetit. “Mund të të interesonte të dije se nuk jam i vetmi që mendoj kështu, dhe se ka një *numër të madh njerëzish* të cilët ndihen njëloj si unë!” Po, dakord, mirë! Çohu në këmbë që të të shoh!

Cila është gjëja e vetme që ju bën të vazhdoni në një situatë si kjo? Gjëja e vetme e cila ju bën të vazhdoni në atë situatë, është që këtë gjë jua ka vendosur Perëndia në zemër. Kjo është gjëja e vetme. Nuk është thjesht rroga që ju paguajnë, nuk është bregdeti ku mund të kënaqeni, nuk ka asnjë shtysë të jashtme që dikush mund të më japë, e cila të jetë mjaft e rëndësishme sa ta mposhtë atë sfidë. E vetmja gjë e cila e mban dikë të përkushtuar ndaj detyrës, është që Perëndia na e ka vendosur atë në zemrat tona që ta bëjmë. Kur jemi plot me vizion, plot me shpresë, plot me potencial, dhe përballemi me qëndrimin që thotë: “E provuam më parë, nuk funksionoi; askush nuk është i ngazëlluar; kjo nuk është punë për ne”, atëherë duhet të mbaheni fort, duhet të lidheni pas direktut, duhet të kaloni përmes stuhisë dhe duhet ta mbani mundësinë gjallë. Nëse Perëndia nuk do t’ia kishte vendosur në zemër që ta bënte këtë gjë, kjo arsye do të mjaftonte që Nehemia të kthehej menjëherë në Suza.

Informacioni

Gjëja interesante tani është mënyra se si reagon ai. Ai reagon duke dhënë *informacion*—informacion, vargu 18. Me fjalë të tjera, ai nuk reagon duke sjellë disa nxitëse tifoza. Ai nuk fillon të brohorasë dhe të thotë: “Ne mund t’ia dalim; ne mund t’ia dalim!”, sikur të ishte duke thënë: “E di që jeni pak të shkurajuar, por më lejoni t’ju them diçka.” Jo, ai thotë: “Më lejoni t’ju

jap ca informacion. Ju e shihni mjerimin në të cilin gjendemi.” Vargu 18 thotë: “U tregova pastaj atyre si dora bamirëse e Perëndisë tim kishte qenë mbi mua si dhe fjalët që mbreti më kishte thënë.” Tani, të dyja këto elemente ishin dhe janë thelbësore. Nëse shkojmë te njerëzit dhe u themi: “E dini çfarë? Thjesht dua t’ju tregoj për dorën e Perëndisë mbi mua”, ata ia kthejnë: “E po, çfarë do të *thotë* kjo në të vërtetë? Si do ta bësh të prekshme këtë gjë kaq subjektive, këtë përjetim joekzistencial për të cilin po na flet? Si mund ta matim një gjë të tillë, si mund ta dimë?”.

Ai, pra, nuk është se thjesht flet me ta, duke përdorur terma të fshehtë frymërorë, por ai vërteton, ai qartëson, ai *ilustron*—kjo ka të ngjarë të jetë më e mira nga të trija; po kërkoj një fjalë—ai e ilustron ndjesinë e dorës së Perëndisë mbi të, duke ju dhënë këtë përshkrim që sapa lexuam në pjesën e parë të kapitullit: “Kisha shumë frikë. Isha lutur. I kisha kërkuar Perëndisë se çfarë duhej të bëja dhe po shpresoja për një mundësi.”

Ata po dëgjonin dhe e pyetën: “Dhe çfarë ndodhi?”.

“E po, unë shkova te zotëria im, siç kisha bërë çdo ditë tjetër. Kësaj here, zotëria im më tha: ‘Pse dukesh kaq i trishtuar? Ti nuk je i sëmurë.’”

Njerëzit po e dëgjonin dhe e pyetën: “Po ti çfarë i the?”.

“E po, unë i thashë: ‘Si të mos jem i trishtuar? Në fund të fundit, populli im është në mjerim, muret janë rrëzuar.’”

“Ia *the* këtë mbretit?”

“Po!”

“Çfarë tha *ai*?”

“E po, ai më tha: ‘Sa kohë do të të duhet të largohesh?’”

“Oh, do të thuash që ai do që ti të kthehesh?”

“Po.”

(Meqë ra fjala, kjo është një gjë shumë domethënëse. Disa prej nesh kanë frikë të kërkojnë një periudhë pushimi, sepse kanë frikë se mos zgjat për gjithë jetën. Nëse zgjat, le të zgjatë.)

Si rezultat i informacionit që ai siguroi në lidhje me ngjarjet reale historike, ai u vuri në dukje dhe u vërtetoi këtyre njerëzve se Perëndia kishte vepruar në zemrën e mbretit. Mbreti kishte dhënë bekimin e tij për gjithçka; ai madje e kishte ndihmuar në mënyrat më praktike. Nehemia ishte në gjendje ta përshkruante të gjithën këtë, dhe si rezultat i tregimit të këtyre ngjarjeve, ai ngjalli siguri te njerëzit, dhe në gjysmën e dytë të vargut 18, ata iu përgjigjën me fjalët: “Të ngrihemi dhe t’i vihemi ndërtimit!”.

Ja tek e keni, e shihni? Si ta zbatoni vizionin? Si e zbaton Nehemia vizionin? E po, ai jep një fjalë nxitjeje, edhe në mes të sfidave të cilat janë të pashmangshme. Kur njerëzit filluan ta pyesnin se çfarë po ndodhte, ai reagoi duke ju dhënë atyre informacion real dhe me fakte.

“Pse do ta bëjmë këtë?”

“Sepse Fjala e Perëndisë thotë se duhet ta bëjmë.”

“Pse po e themelojmë këtë lloj shërbese apo këtë lloj iniciative?”

“Sepse kjo është brenda parametrave dhe parimeve të Fjalës së Perëndisë.”

“Pse mendojmë se do të jetë e suksesshme apo e drejtë në këtë kohë?”

“Për shkak të A, B, C dhe D.”

Ju e shihni që jemi gati me informacionin, si rezultat i faktit që kemi bërë vëzhgimin dhe si rezultat i faktit që kemi pritur 120 ditë në lutje para Perëndisë, përpara se të hidheshim në ndonjë nga strategjitë tona.

Zbatimi

Kjo na sjell te fjala e gjashtë, e cila është *zbatimi*—zbatimi. Duhej të kishte një ndarje të kujdesshme të detyrave dhe përgjegjësive. Kjo vjen më vonë në histori. Mirëpo, tani për tani ata janë hedhur në veprim. Ka shumë rrënoja të cilat duhet të pastrohen, prandaj, ata i përveshin menjëherë mëngët.

Kur udhëheqja e mbjell një vizion të tillë në nivelin bazë, ndryshimi do të bëhet i dukshëm. Mendoj se nëse vizioni është dhënë nga Perëndia dhe paraqitet me përvulësi, atëherë, Perëndia do ta mbjellë atë në zemrat e njerëzve dhe ata *do të* përgjigjen: “Le të fillojmë rindërtimin!”. Përgjigja nuk është: “Sa të gëzuar që jemi ta dëgjojmë këtë! Vazhdo Nehemia, jepi drejtim!”. Jo, ata e personalizuan menjëherë vizionin. Ata thanë: “Kjo ka lidhje me ne. Papritur, në këtë moment, ekzistenca jonë ka kuptim. Papritmas, gjithë kjo rrënojë është sfidë për ne. Papritur, teksa të dëgjonim ty, Nehemia, e kuptuam që çështja reale nuk janë portat dhe muret; çështja reale është Perëndia dhe lavdia e tij. Dhe ne kemi qenë duke u kënaqur me këtë situatë. Nuk i kemi ngritur sytë tanë për të parë fushat.¹² Jemi shqetësuar për ushqimin që hamë për tani: “Në cilin restorant do të shkoni?””.

Jezusi thotë: “Unë kam një ushqim për të ngrënë të cilin ju nuk e njihni.”¹³ Ata po shohin njëri-tjetrin dhe po thonë: “Çfarë po ndodh këtu? Para një ore ishim të shqetësuar për drekën; tani që ne u kthëm me drekën, ai nuk do të hajë; tani paska ushqim.” Ata madje panë njëri-tjetrin dhe thanë: “Mos i solli vallë dikush për të ngrënë?”¹⁴ Gruaja nuk e kuptoi kur Jezusi po i fliste për ujin,¹⁵ dhe ata nuk e kuptuan kur ai u foli për ushqimin.

¹² Shih Gjoni 4:35.

¹³ Gjoni 4:32.

¹⁴ Gjoni 4:33.

¹⁵ Shih Gjoni 4:7–15.

Në kishat tona, shumë prej nesh janë të shqetësuar në lidhje me atë që është për *tani*, që është tokësore dhe kalimtare, dhe jo në lidhje me gjërat që nuk duken, të cilat sigurisht që janë të përjetshme në rëndësinë e tyre.¹⁶

“Le të fillojmë nga rindërtimi; [Kështu] ata e filluan këtë punë të madhe.”

Një nga pikat e kthesës, siç duhet ta dinë disa prej jush që kanë jetuar mjaft gjatë në moralin e popullatës britanike në kulmin e Luftës së Dytë Botërore, ishte kur Winston Churchill-i mbajti një fjalim nga qendra e komandës së tij, një bunker nëntokë. Për sa i përket motivimit dhe inkurajimit të njerëzve për t'i vënë gjërat në zbatim, ai fjalim i ka qëndruar provës së kohës si një ilustrim i mrekullueshëm. Nuk mund ta lexoj dot ashtu si e meriton, por dua të lexoj të paktën një pjesë të tij. Meqë ra fjala, Winston Churchill-i është një ilustrim i mrekullueshëm për të folurit në publik, apo jo? Ky ishte një burrë i cili kishte dy dobësi të natyrshme: njëra ishte që ishte thuthuq, dhe tjetra që i merrej goja. Ai u bë oratori më i madh në botën anglishtfolëse në shekullin e njëzetë. Ai i ktheu të dyja këto mangësi në sukses. Njerëzit e kopjonin, dhe nuk e kuptuan se, në fakt, kjo ishte ajo që po ndodhte; ata menduan se ky ishte stili i tij! Ai duhet të jetonte në kohën tonë dhe të bënte ca marketing. Gjithsesi, ja se çfarë tha ai:

Nuk kam asgjë për t'ju ofruar, përveçse gjak, mund, lot dhe djersë. ... Cili është synimi ynë? Mund t'ju përgjigjem me një fjalë të vetme: ... fitore, fitore me çdo kusht, fitore pavarësisht... tmerri, fitore, pavarësisht se sa e gjatë dhe e vështirë që mund të jetë rruga; sepse pa fitore nuk ka mbijetesë.¹⁷

Nuk do të dorëzohemi dhe as do të dështojmë. Ne [do të] vazhdojmë deri në fund; ne [do të] luftojmë në Francë; do të luftojmë [në]... dete dhe oqeanë; [do të] luftojmë me një siguri dhe forcë gjithnjë e më të madhe në ajër; do ta mbrojmë ishullin tonë, pavarësisht çmimit; do të luftojmë në plazhe, do të luftojmë në aerodromë, do të luftojmë në fusha dhe në rrugë, do të luftojmë në kodra; nuk do të dorëzohemi kurrë, edhe sikur ky ishull ose një pjesë e madhe e tij të

¹⁶ 2 e Korintasve 4:18 (parafrazim).

¹⁷ Winston Churchill, “Blood, Toil, Tears and Sweat” (fjalim para House of Commons, Londër, 13 maj 1940), <https://winstonchurchill.org/resources/speeches/1940-the-finest-hour/blood-toil-tears-and-sweat-2/>.

pushtohej dhe të vuante nga uria, gjë të cilën nuk e besoj as edhe për një çast, atëherë perandoria jonë përtej deteve, e armatosur dhe nën mbrojtjen e flotës britanike, do ta vazhdonte luftën, derisa në kohën e mirë të Perëndisë, Bota e Re, me gjithë fuqinë dhe forcën e saj të dalë përpara për ta shpëtuar dhe ... çliruar botën e vjetër.¹⁸

Në atë moment, Londra e mposhtur, e rrënuar dhe e përgjakur, nisi të ngrinte kokën. Po ashtu lagjja “Clydeside” e Glasgow-t, e cila ishte shkatërruar nga bombat gjermane, filloi të nxirrte burra dhe gra sypatrembura. Ata që nuk ishin bërë pjesë e ushtrisë për shkak të ndonjë dobësie fizike, filluan të identifikoreshin me frontin në numra të konsiderueshëm. Gjatë ditës ata kishin një punë në qytet dhe gjatë natës ishin të veshur me uniformë. Ata dilnin dhe qëndronin në vende të ndryshme, duke vëzhguar me imtësi shkatërrimin, dhe nuk është se mund të bënin ndonjë gjë për ta penguar ndonjë sulm të madh nga ana e armikut. Mirëpo, çfarë ndodhi? Dikush që kishte një vizion në zemër, ua kishte ngulitur edhe atyre në thelb të qenies së tyre. Prandaj, në nivelin bazë, dëgjoji gjithë këto këngë të shkurtra të mahnitshme, të cilat këndoheshin nga njerëzit nëpër rrugë:

Me kë mendon se po tallesh, z. Hitler,
Nëse thua që Anglia Plakë mori fund?

Jemi ne burrat që do t’i japim fund lojës sate!
Jemi ne djelmoshat që do të të bëjmë të mendohesh sërish.
Me kë mendon se po tallesh, z. Hitler,
Nëse thua që Anglia Plakë mori fund?

Z. Brown shkon të punojë në qytet në 8:31,
Në tre e gjysmë kthehet në shtëpi për të ngrënë zëmër.
Gati është ai me dyfek në sup.
Me kë mendon se po tallesh, z. Hitler,
Nëse thua që Anglia Plakë mori fund?¹⁹

¹⁸ Winston Churchill, “We Shall Fight on the Beaches” (fjalim para House of Commons, Londër, 4 qershor 1940), <https://winstonchurchill.org/resources/speeches/1940-the-finest-hour/we-shall-fight-on-the-beaches/>.

¹⁹ Jimmy Perry, “Who Do You Think You Are Kidding, Mr. Hitler?” Parafrazim.

Nga erdhi kjo? Erdhi nga udhëheqja vizionare. Ata nuk kishin një mushqetë për t'u mbrojtur, por ata thanë: “*Ne do ta bëjmë!*”.

Disa prej nesh po i ulin poshtë bashkësitë tona: “Oh, nuk e di pse askush nuk del vullnetar! Nuk e di pse askush nuk po nis ndonjë shërbesë. Nuk e di pse nuk po ndodh kjo gjë, dhe pse nuk po ndodh ajo gjë.” Le t'i hedhim një vështrim të mirë vetes. Le të dëgjojmë disa prej predikimeve tona. Le të konsiderojmë reagimin dhe kundërveprimin tonë. Le të shqyrtojmë veten tonë. Le të fillojmë së pari me veten. A dëshiron rizgjim? Bëj atë që tha Gipsy Smith: “Bëj një rreth me shkumës në dysHEME; qëndro brenda tij dhe kërkoji Perëndisë të rizgjojë gjithçka gjendet brenda atij rrethi!”²⁰ Nëse kishat tona do të trazohen dhe lëvizen nga Perëndia, ne jemi shumë thelbësorë, jo për faktin se kush jemi, por për shkak të modelit që Perëndia ka caktuar për udhëheqjen.

Kundërshtimi

Së shtati, pavarësisht gjithë këtyre, kishte *kundërshtim*, dhe gjithmonë do të ketë—një trini të pashenjtë si kjo që gjejmë në vargun 19. Kurdoherë që puna e Perëndisë bëhet në mënyrën e Perëndisë, kundërshtimi është i pashmangshëm. Këtë nuk kemi pse ta themi sërish. Ata u afruan dhe pyetën: “Çfarë mendoni se po bëni? Sigurisht që po bëni shaka.” Sarkazëm, tallje, përqeshje, shkurajim. “Mos doni, vallë, të ngrini krye kundër mbretit?” Sa i lumtur duhet të ketë qenë Nehemia, që të fuste dorën në xhep dhe t'u tregonte letrat e miratimit nga vetë mbreti!

Disa prej nesh që janë këtu sot, do të përballen me kundërshtim të madh. Kjo është një përleshje e vërtetë në shërbesën pastorale, apo jo? Është e vështirë të dish se ç'të bësh. Mendoj

²⁰ Atribuar Gipsy Smith-it në librin e John N. Hamblin-it, *Fire in the Pulpit* (Murfreesboro, TN: Sword of the Lord, 2005), 171. Parafrazim.

se unë vetë i kthehem vazhdimisht vargut që ju përmenda në sesionin e parë: 2 e Timoteut 4:5. Çfarë duhet të bëjmë? E para: “Ruaj mendjen tënde!”. Mos lejo që ndokush të ta trazojë mendjen; ruaje mendjen! E dyta: “Duro vështirësitë!”. Kush tha vallë që do të ishte argëtim? Argëtimi është shtesë. Ne presim argëtim, por nuk është gjithmonë argëtim. Nuk planifikoj që të argëtohem. *Nuk ka ditë të mërzitshme*. U them burrave në ekipin tim pastoral: “Hej, kjo është shumë argëtuese, apo jo?”.

Ju thoni: “Kjo është shkatërrim.”

Unë u them: “E di që është shkatërrim, ama është një lloj shkatërrimi argëtues, apo jo?”.

Ju thoni: “E po, nuk jam i sigurt për këtë.”

E po, më lejoni që... Dëgjoni, për shkak se keni ditë të kënaqshme, keni edhe ditë të vështira, ama nuk keni ditë të mërzitshme. Mërzitja është brenda jush. Mërzitja është dita e shtatë e pushimeve verore: “Oh, s’kam se çfarë të bëj; do të doja të isha në shkollë.” Do të doja që edhe ju të ishit në shkollë, fëmijë mistrecë. Cili është problemi? Ka tenis, golf, not dhe çiklizëm; ka ngjitje në pemë dhe ka rrëzime. Ka aq shumë për gjëra që mund të bësh, sa nuk i bën dot të gjitha! Cili është problemi? Problemi është brenda. Nëse diçka është e mërzitshme, është për shkak se *ju jeni* të mërzitur. Nëse martesja juaj është e mërzitshme, kjo ndodh për shkak se ju jeni të mërzitur. Kjo është e vështirë për t’u pranuar, por është e vërtetë.

Afirmimi

Prandaj, ai e afirmon; kjo është fjala e fundit—*afirmimi*. Kishim tetë fjalë. Nëse kujtoni më shumë se gjashtë, do t’ju vendos notën 10. Pra, nëse i mbani mend. Unë për vete nuk i mbaj mend. Vargu 20: “Atëherë unë u përgjigja dhe u thashë atyre: ‘Do të jetë vetë Perëndia i qiellit që do të na sigurojë suksesin.’” Psalmi 121 thotë: “Unë i ngre sytë nga malet: nga do të më vijë

ndihma? (Ky është një nga psalmet metrike.) Ndhima ime vjen nga Zoti, që ka bërë qiejt dhe tokën.”

“Hej, Nehemia, çfarë mendon se po bën? Kush kujton se je?”

“Jo.”

“Si mendon se do ta bësh këtë?”

“Perëndia do ta bëjë. Perëndia do të bëjë. Oh, ai do ta bëjë përmes nesh, ama Perëndia do ta bëjë! Perëndia i qiellit do të na japë sukses!” Hudson Taylor-i tha: “Punës së Perëndisë, që bëhet në mënyrën e Perëndisë, nuk do t’i mungojë kurrë [furnizimi] i Perëndisë.”²¹ Nehemia u tha: “Meqë ra fjala, largohuni prej këtej, sepse ju nuk keni asnjë pjesë në këtë qytet historik. Ky është vendi ynë; ju nuk keni asnjë autoritet ligjor këtu. Nuk keni asnjë të drejtë mbi të; nuk keni as pjesë në të. Por Perëndia ynë do të na japë sukses dhe ne do të vazhdojmë me rindërtimin.”

A mund t’ju bëj një pyetje të fundit? Le t’ia bëjmë vetes këtë pyetje: “Për çfarë po i besojmë Perëndisë që ai ta bëjë, gjë e cila është aq e pabesueshme, saqë nuk mund të arrihet pa aftësimin e tij hyjnor? Ç’gjë po i besojmë Atij që të bëjë në shërbesën tonë këto ditë, e cila është aq e pabesueshme saqë, nëse do të ndodhte, njerëzit të thoshin: “Me siguri, Perëndia është në këtë vend”?”²² A është e drejtë që të mendojmë kështu? Unë them se po.

Dishepujt erdhën te Jezusi dhe i thanë: “Jezus, mendojmë se është momenti ta përcjellim turmën. Ata kanë qenë këtu për një kohë shumë të gjatë; dyqanet janë mbyllur dhe nuk kanë se ku të gjejnë ushqim. Do të kemi një problem të madh, me të cilin do të na duhet të merremi. Të lutemi, nisi për në shtëpi.”

Jezusi u thotë: “Pse nuk u jepni ju diçka për të ngrënë?”.

²¹ J. Hudson Taylor, cituar në librin e M. Geraldine Guinness-it, *The Story of the China Inland Mission*, botimi i tretë (London: Morgan and Scott, 1894), 1:238.

²² Shih Zanafilla 28:16.

“Si the?”

“Po!”

“E po, ne nuk kemi asgjë. E vetmja gjë që kemi gjetur, është një djalë i vogël; ai ka pesë bukë dhe dy peshq. Por çfarë janë këto për kaq shumë njerëz? Nuk mendoj se mund t’i ushqesh pesë mijë burra , plus gratë dhe fëmijët, me pesë bukë dhe dy sardele, apo jo?”²³

Sigurisht që ju e dini historinë. E dini se si jepet mësim nëpër shkollat e së dielës. Krejt ndryshe—nuk jam i sigurt se si është në kurikulën që ka nxjerrë shtëpia botuese *Puritan and Reform*, por në disa kurikula të tjera, është shumë keq. Zbatimi për mësuesin: “A nuk do të doje të ishe një djalë i vogël si ky, që ia dha drekën e vet Jezusit? A nuk do të doje të ishe i rëndësishëm ashtu si ky djalë? A nuk do të doje që të ishe zgjidhja e problemit për Jezusin? Ja ku ishte ai me gjithë ata njerëz. Të gjithë ishin të uritur dhe s’kishin agjë për të ngrënë, dhe në pikën e nevojës së tij më të madhe, ja ku erdhi ai djalë i vogël dhe *fap* e zgjidhi problemin.”

Sigurisht, mrekullia nuk është që djali i vogël ofroi drekën e tij; mrekullia është që Jezusi *përdori* drekën e atij djali të vogël. Mrekullia nuk është që Nehemia udhëtoi një mijë e pesëqind kilometra për ta bërë detyrën. Mrekullia është që Perëndia përdori Nehemian për atë detyrë. Mrekullia nuk ka të bëjë me faktin që ne ia kushtojmë veten shërbesës në një kauzë të madhe dhe që i shërbejmë një Mbreti dhe Komandanti të madh; mrekullia është që na është dhënë një rol në përmbushjen e planit të Perëndisë. Ai që mund të krijonte nga hiçi të gjitha llojet e vaktit të drekës, denjon të përdorë pesë sanduiçë të vegjël dhe dy peshq. Ai që sundon mbi gjithçka, denjon të hedhë vështrimin mbi ju dhe mua, dhe të thotë: “Hej, do të të jap edhe ty një rol.” Çfarë misteri i madh! Çfarë privilegji i madh!

²³ Shih Mateu 14:15–17; Marku 6:35–38; Luka 9:12–13; Gjoni 6:5–9.

Zoti na bëftë që të ngremë vështrimin lart dhe të themelojmë një vizion! Çfarë tha Wesley? “Më jep njëqind burra që nuk urrejnë asgjë tjetër përveç mëkatit dhe që e duan Perëndinë me gjithë zemrat e tyre, dhe kam për ta shkundur Anglinë për Jezu Krishtin.”²⁴ A besojmë me të vërtetë që nga thjeshtësia e një ndërtese si kjo, në cep të një qyteti të tillë historik, Perëndia mund të ndezë një flakë, e cila nuk do të shuhet kurrë, teksa hyjmë në shekullin e njëzetënjëtë? Për çfarë po i besojmë Perëndisë që Ai ta bëjë, gjë e cila është aq e pabesueshme, saqë mund të arrihet vetëm si rezultat i ndërhyrjes së tij hyjnore?

O Atë, të bekojmë sërish për Fjalën tënde! Lutem që t’i heqësh të gjitha ato fjalë të cilat janë nga unë, dhe të lësh ato që janë nga ti. Bëj që të gjithë ne, duke qenë se jemi bashkëpunëtorë, ta njohim rrezikun e madh të të imagjinuarit se po jetojmë në një nivel në të cilin, në të vërtetë, nuk po jetojmë! Si rezultat i imagjinatave tona, ne predikojmë në po atë nivel, dhe i bëjmë njerëzit të mendojnë që, në fakt, po bëjmë gjëra të cilat nuk po i bëjmë, dhe kështu turpërojmë veten dhe i shkurajojmë të tjerët. Të lutemi, na kthe sërish te gjërat bazë! Duam të përkushtohemi për të qenë burra dhe gra për të vërtetën tënde. Duam që t’i kushtohemi lutjes dhe shërbesës së Fjalës.²⁵ Na beko tani, ndërsa e kalojmë bashkë këtë kohë, dhe na jep zemra mirënjohëse për gjithçka që kemi! Ne lutemi në emrin e Jezusit. Amen.

²⁴ John Wesley drejtuar Alexander Mather-it, cituar në librin e Luke Tyerman-it, *The Life and Times of the Rev. John Wesley, M.A., Founder of the Methodists* (London: Hodder and Stoughton, 1871), 3:632. Parafrazim.

²⁵ Shih Veprat 6:4.